



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Rruga: "Abdi Toptani", ish-hotel "Drini", Tiranë

Tel: 2268141; 04 2268142

Nr. 519/11 Akti

Tiranë, më 19.07.2017

V E N D I M

Nr. 171, datë 19.07.2017

*"Mbi përfundimin e verifikimit të informacionit të marrë nga punonjësi *****,
protokolluar me kërkesat nr. 519 prot., datë 8.8.2016 dhe nr. 519/8 prot., datë 14.10.2016"*

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar; neneve 79 – 90, të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.3.2015 të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me verifikimin e informacioneve të protokolluara pranë Komisionerit me nr. 519 prot., datë 8.8.2016 dhe nr. 519/8 prot., datë 14.10.2016, për disa pretendime të ngritura lidhur me parregullsi në kryerjen e procesit të vlerësimit në përfundim të periudhës së provës dhe konfirmimit të statusit të nëpunësit civil,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nga përmbajtja e kërkesave të dërguara nga nëpunësi ***** , regjistruar me nr. 519 prot., datë 8.8.2016 dhe nr. 519/8 prot., datë 14.10.2016, është njohur me disa pretendime të këtij punonjësi që kanë të bëjnë me disa shkelje të pretenduara në lidhje me mënyrën e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, gjatë procesit të konfirmimit të tij si nëpunës civil.

Konkretisht, pretendimet e ankuesit, kanë të bëjnë me parregullsi gjatë procedurave të procesit të vlerësimit në përfundim të periudhës së provës, dhe konfirmimit të statusit të nëpunësit civil, të lejuara nga ana e prororit direkt.

Për këtë arsye, bazuar në Urdhrin nr. 519/1 prot., datë 5.9.2016, të Komisionerit, "Për verifikimin e informacionit të ardhur nga ***** , në lidhje me procedurën e konfirmimit si nëpunës civil", si dhe në Urdhrin nr. 627 prot., datë 21.10.2016, të Komisionerit, "Për verifikimin e informacionit, në lidhje me lirimin nga shërbimi civil të punonjësit *****", ka nisur verifikimin e këtij rasti.

Nga hetimi administrativ që është kryer për shqyrtimin e këtij rasti, rezulton se, punonjësi ***** , me aktin nr. 305/5 prot., datë 25.4.2016, të Departamentit të Administratës Publike, në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, është emëruar nëpunës civil në periudhë

prove, në pozicionin e punës, “*Specialist Jurist, në Sektorin Juridik dhe Marrëdhëniet Ndërkombëtare*”, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar. Mbi këtë bazë, Drejtori i DSIK, me shkresën nr. 1087 prot., datë 28.4.2016, ka urdhëruar fillimin e marrëdhëniet të punës, në datën 1.5.2016.

Duke qenë para një rasti specifik, pasi ndërprerja e marrëdhëniet të punës së nëpunësit të rikthyer me vendim gjyqësor, ishte bërë pothuaj në përfundim të periudhës së provës (*11 muaj dhe 1 javë*), Departamenti i Administratës Publike, në aktin e emërimit, ka sqaruar se, për nëpunësin *****, “*...Kohëzgjatja e periudhës së provës në pozicionin Specialist Jurist, do të llogaritet duke përfshirë edhe periudhën e provës (së mëparshme) në pozicionin Specialist i Sigurimit të Informacionit dhe Korrier Diplomatik, në Drejtorinë e Vetting-ut dhe Regjistrin Qendror, në DSIK*”, pra duke u marrë si një e tërë, pavarësisht pozicionit të ri.

Pas plotësimit të afatit një vjeçar të provës, eprori direkt, Drejtori i Drejtorisë së Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore, duke mos marrë parasysh orientimin e dhënë nga organi kompetent, por me arsyetimin se, është në pamundësi të vlerësimit të plotë të nëpunësit për shkak se i nevojitet më shumë kohë, me vendimin nr. 1466 prot., datë 25.5.2016, ka vendosur shtyrjen për 4 muaj, të periudhës së provës për punonjësin ***** , deri në datën 27.9.2016.

Kundër këtij vendimi, bazuar në pikën 14, të Kreut VI, të Vendimit nr. 243 datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, nëpunësi civil në periudhë prove, ***** , ka ushtruar të drejtën e ankimit tek Drejtori i DSIK, si nëpunësi më i lartë civil i institucionit. Ky i fundit, pas shqyrtimit të këtij ankimi, me aktin nr. 1630 prot., datë 30.5.2016, ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të aktit të eprorit direkt, duke arsyetuar edhe shkaqet e kësaj vendimarrje.

Pasi e ka marrë në rishqyrtim rastin, me aktin nr. 1637 prot., datë 7.6.2016, eprori direkt, ka mbajtur të njëjtin qëndrim, duke e shtyrë përsëri periudhën e provës me të njëjtin argument.

Vendimi i eprorit direkt, është ankimuar përsëri nga nëpunësi ***** , tek Drejtori i DSIK, i cili, pas trajtimit të ankimit, me Vendimin nr. 1935 prot., datë 27.6.2016, ka vendosur përsëri, shfuqizimin si të paligjshëm, të aktit të eprorit direkt (*nr. 1637 prot., datë 7.6.2016 “Për shtyrjen e periudhës së provës”*), duke konkluduar se, vendimi ka dalë në tejkalim të së drejtës që i jep ligji eprorit direkt në këtë rast, si dhe duke mos pasqyruar shkaqet të arsyetuara ligjore për të arritur në konkluzionin e “*shtyrjes së periudhës së provës*”.

Drejtuesi i institucionit, i ndodhur para fakteve si më sipër, nëpërmjet shkresës nr. 1537, datë 16.6.2016, ka kërkuar interpretimin e çështjes nga ana e Departamentit të Administratës Publike, i cili, në cilësinë e Autoritetit Përgjegjës, për përgatitjen, mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave shtetërore në shërbimin civil, ka bërë interpretimin dhe sqarimet e nevojshme, nëpërmjet shkresave nr. 3248/1 prot., datë 27.6.2016 dhe nr. 4924/3, datë 13.9.2016.

Departamenti i Administratës Publike, në përmbajtjen e shkresave të evidnetuara më sipër, në interpretim të dispozitave ligjore në lidhje me këtë rast, dhe konkretisht, të pikës 4, të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar, pikës 6 dhe 7, Kreu III, të Vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të*

nëpunësve civilë”, si dhe pikave 10 e 11, Kreu VI, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në*

katëgordinë ekzekutive”, ka orientuar se, vlerësimi përfundimtar nga eprori direkt duhet të marrë për bazë vlerësimin e mëparshëm 11 muaj e 1 javë, si dhe duke bërë vlerësimin e punës për periudhën e mbetur të provës, e cila llogaritet 23 ditë.

Në rastin konkret, eprori direkt, Drejtori i Drejtorisë së Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore, në vlerësimin e tij përfundimtar për këtë nëpunës, do të duhej të merrte për bazë:

Së pari, vlerësimin e pjesshëm, të bërë sipas formularit të vlerësimit për nëpunës civil në periudhë prove (për periudhën 12.8.2012 – 19.7.2013), përkatësisht, nga zyrtari raportues, në këtë rast punonjësi *Enton Sadiku*, me detyrë “Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit Qendror” dhe zyrtari kundërfirmues, që në këtë rast paraqitet punonjësi *Mark Ndreca*, me detyrë “Drejtor i Drejtorisë së Vetting-ut dhe Sigurimit Industrial”, të cilët e kanë vlerësuar në nivelin 2 – mirë;

Së dyti, mendimin e nëpunësit përgjegjës për mbikëqyrjen e periudhës së provës, në këtë rast paraqitet punonjësi *Pëllumb Elezi*, i cili ka vlerësuar pozitivisht performancën në punë të punonjësit në fjalë për periudhën 1.5.2016 – 23.5.2016.

Së treti, rezultatin e testimit në përfundim të ciklit të detyrueshëm të trajnimit në ASPA, të cilin, punonjësi *****, e ka kryer në ITAP, sipas çertifikatës lëshuar datë 28.9.2012 (për shkak se emërimi është bërë në kohën që ishte në fuqi ligji nr. 8549, dt. 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe punonjësi është rikthyer në shërbimin civil, për shkak të një vendimi gjyqësor).

Nga këqyrja e akteve administrative gjatë këtij hetimi administrative, konstatohet se, eprori direkt, në vlerësimin e tij në përfundim të periudhës së provës (1.5.2016 – 23.5.2016), nuk ka marrë për bazë vlerësimin paraprak të bërë nga eprorët në pozicionet e mëparshme ku ka punuar nëpunësi në periudhë prove. Për më tepër, formulari i vlerësimit, rezulton me mangësi, pasi nuk është plotësuar prej tij niveli i vlerësimit në ndarjet “C” dhe “Ç”, ndërsa, nëpunësi autorizues, i cili ka vendosur të bëjë rivlerësimin e nëpunësit civil në periudhë prove, nuk është shprehur për nivelin e vlerësimit, ç’ka e bëjnë të pavlefshëm formularin e vlerësimit të punës.

Në këto kushte, DAP, e ka orientuar institucionin që të bëjë plotësimin e formularit të vlerësimit dhe, në bazë të pikës 4, Kreu III, të Vendimit nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, ka nënvizuar me të drejtë që, në ato raste, kur ka mosmarrëveshje midis zyrtarit autorizues dhe/ose zyrtarëve kundërfirmues dhe raportues, lidhur me nivelet e vlerësimit, vendimi përfundimtar për vlerësimin e rezultateve në punë, në mënyrë të arsyetuar, merret nga zyrtari autorizues.

Më tej, në shkronjën “b”, pika 7, Kreu VI, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në katëgordinë ekzekutive”, parashikohen rastet e mundësisë të zgjatjes, një herë të vetme, të periudhës së provës (për më tepër që periudha e provës, për shkaqe të pavarura prej nëpunësit, ka filluar në kohën që ishte në fuqi ligji nr. 8549, dt. 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe sipas nenit 68, pika 2, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, çdo procedurë e nisur përpara shtrirjes së efekteve të ligjit të fundit të shërbimit civil, do të përfundohet sipas dispozitave të ligjit nr. 8549, dt. 11.11.1999, “Statusi i nëpunësit civil”).

Duke mos qenë në asnjë nga rastet e parashikuara në këtë pikë, eprori direkt, ka nënvizuar DAP, nuk mund të legjitimohet për të zgjatur periudhën e provës.

Ashtu si rezulton nga përmbajtja e shkresës së ardhur nga institucioni i DSIK, me nr. 2181 prot., datë 24.10.2016, drejtuar Komisionerit, mbi bazën e orientimeve të DAP, Drejtori i DSIK, në cilësinë e zyrtarit autorizues, ka bërë vlerësimin përfundimtar të nëpunësit ***** në fund të periudhës së provës, në nivelin “2- mirë”, veprim i materializuar në procesverbalin administrativ nr. 2465 prot., datë 20.9.2016, “Për evidentimin e plotësimeve në formularin e vlerësimit të punës së nëpunësit në periudhë prove ***** për periudhën 1.5.2016 – 23.5.2016”, për të cilin është informuar edhe Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr. 1938, datë 20.9.2016.

Pas kryerjes së këtij veprimi administrativ, pra, pas vlerësimit pozitiv në fund të periudhës së provës, në zbatim të pikës 3, të nenit 24, të ligjit për nëpunësin civil, bëhet i mundur vazhdimi i procedurës për konfirmimin si nëpunës civil, të punonjësit *****.

Por, rezulton se është vepruar në të kundërt nga ana e eprorit direkt, i cili me aktin administrativ nr. 2653, datë 13.10.2016, ka vendosur mos konfirmimin si nëpunës civil të punonjësit ***** në pozicionin “Specialist Jurist, në Sektorin Juridik dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare”, duke përdorur përsëri si argument kryesor pamundësinë e vlerësimit të plotë të nëpunësit për shkak se i nevojitej më shumë kohë. Më tej, rezulton se me Urdhrin nr. 2654, datë 13.10.2016, e ka liruar nga shërbimi civil këtë punonjës (ky urdhër aktualisht nuk ekziston zyrtarisht në protokollin e arkivës së DSIK-së, pasi është ç’regjistruar nga Regjistri i Akteve Normative në DSIK, si akt i pabazuar në ligj).

Kundër këtij vendimi, nëpunësi ***** ka ushtruar përsëri të drejtën e ankimit, nëpërmjet memos nr. 107 prot., datë 17.10.2016, drejtuar Drejtorit të DSIK. Pas shqyrtimit të ankimit, me Vendimin nr. 2433 prot., datë 25.10.2016, të Drejtorit të DSIK, është vendosur pranimi i ankesës, duke arritur në konkluzionin se, vendimarrja e eprorit direkt, është bërë pas një sërë vendimesh të kontestuara e të shfuqizuara, jo në përputhje me ligjin, duke mos reflektuar urdhërimet e DAP, si dhe jashtë afateve ligjore.

Nisur nga ky shkak, titullari i institucionit, në cilësinë e eprorit direkt, me aktin nr. 3260, datë 21.12.2016, ka kërkuar fillimin e ecurisë disiplinore ndaj nëpunësit ***** me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore, për shqyrtimin e shkeljes disiplinore “mospërbushje e detyrave”, e cila parashikohet në pikën 8, Kreu 6, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, ku përcaktohet shprehimisht se:

“Mosrealizimi i procedurës së përcaktuar në pikën 7, të kreut VI, të këtij vendimi, (që ka të bëjë me vendimarrjen nga eprori direkt në fund të periudhës së provës), brenda një afati 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike, konsiderohet “mospërbushje detyre” nga eprori direkt”.

Për shkak se shkelja “mospërbushje e detyrave”, sipas pikës 3, shkronja “a”, të nenit 57, të ligjit, konsiderohet shkelje e rëndë disiplinore, në bazë të pikës 2, të nenit 59, procedimi disiplinor, kryhet nga Komisioni i Disiplinës, i cili ka kompetencën, për shqyrtimin e shkeljeve disiplinore në këtë rast.

Në këto rrethana, sipas kërkesave ligjore të përcaktuara në nenin 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, në Vendimin nr. 115, datë 5.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në Komisionin

Disiplinor në Shërbimin Civil”, si dhe në Udhëzimin nr. 1, datë 2.4.2014, të Departamentit të Administratës Publike, “Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, me Urdhrin nr. 3290, datë 29.12.2016, të titullarit të

institucionit, “Për ngritjen e Komisionit Disiplinor në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”, është ngritur Komisioni i Disiplinës, përbërja e të cilit, rezulton në përputhje me pikën 2, Kreu I, “Organet disiplinore”, të VKM nr. 115, datë 5.3.2014.

Komisioni i Disiplinës, ka filluar ecurinë disiplinore ndaj nëpunësit ******, por ndërkohë, gjatë zhvillimit të kësaj procedure, titullari i institucionit, i cili ishte njëkohësisht edhe Kryetar i Komisionit të Disiplinës, ka dhënë dorëheqjen dhe me aktin nr. 1242/1 prot., datë 28.2.2017, të Departamentit të Administratës Publike, është liruar nga pozicioni i rregullt “Drejtor i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar”.

Për këtë shkak, Komisioni i Disiplinës, me Vendimin nr. 610, datë 27.2.2017, “Për pezullim të ecurisë disiplinore”, ka vendosur pezullimin e ecurisë disiplinore ndaj ******, deri në zëvendësimin e Drejtorit të DSIK-së, njëkohësisht edhe Kryetar i Komisionit të Disiplinës.

Konstatohet se ky proces ka mbetur në këtë fazë edhe pas emërimit në detyrë të Drejtorit të Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikua, sipas Urdhrit nr. 23, datë 28.2.2017, të Kryeministrit, “Për emërim në detyrë”. Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, aktualisht nuk ndodhemi në kushtet e pezullimit të veprimtarisë së Komisionit të Disiplinës, pasi titullari i institucionit është në detyrë dhe ushtron rregullisht aktivitetin e tij, ç’ka do të thotë se shkak i pezullimit nuk është prezent. Për këtë arsye, duhet të revokohet akti i pezullimit të ecurisë disiplinore dhe të rifillojë aty ku është ndërprerë procedura disiplinore që ka nisur në këtë rast.

Në përmbledhje të sa parashtroam më sipër, në aktet administrative objekt shqyrtimi, konstatohet se, veprimet e Drejtorit të Drejtorisë së Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore, si epror direkt i nëpunësit ******, janë në mënyrë të përsëritur në kundërshtim me ligjin, në tejkallim të të drejtës ligjore, si dhe në kushtet e mosplotësimit të detyrimeve të parashikuara në pikat 6, 7 dhe 10, të Kreut VI, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.

Nga ana tjetër, meqënëse prej institucionit të DSIK, është reaguar duke plotësuar formularin e vlerësimit të punës, në zbatim të procedurës dhe detyrimeve të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, Vendimin nr. 109, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, në këtë rast, mundësohet vazhdimi i procedurës për konfirmimin si nëpunës civil të punonjësit ******, në pozicionin e punës “Specialist Jurist, në Sektorin Juridik dhe Marrdhënieve Ndërkombëtare”, në Drejtorinë e Financës, Shërbimeve Mbështetëse dhe Mbikëqyrjes Shtetërore, në Drejtorinë e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar.

Në këto kushte, për të rregulluar situatën ligjore, njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore pranë institucionit Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, duhet të marrë masa për të finalizuar procesin e konfirmimit, në rastin e punonjësit ******, duke ndjekur hapat e mëposhtëm:

- a. Në kuptim të nenit 24, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe kreut VI, pika 6, e në vijim të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, eprori direkt i pozicionit, “Specialist Jurist, në Sektorin Juridik dhe Marrdhënieve Ndërkombëtare”, të finalizojë periudhën e provës, me nxjerrjen e aktit individual përkatës, duke marrë për bazë edhe vlerësimin e mëparshëm të punës në pozicionin “Specialist i Sigurimit të Informacionit dhe Korrier Diplomatik, në Drejtorinë

e Vetting-ut dhe Regjistrin Qëndror”, sipas përcaktimeve të pikave 6,7 dhe 10, të Kreut VI, të vendimit të sipërcituar.

- b. Vendimi i eprorit direkt, duhet t’i njoftohet nëpunësit ***** dhe njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike, i cili, në kuptim pikës 13, Kreu VI, të aktit nënligjor të mësipërm, në rastin e vendimit të konfirmimit, duhet të përmbyllë këtë proces, nëpërmjet nxjerrjes së aktit të deklarimit të statusit të nëpunësit, brenda 10 ditëve, nga data e njoftimit të konfirmimit nga institucioni Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si dhe të realizojë shënimet përkatëse në Regjistrin Qendror të Personelit.

Duke vpruar në këtë mënyrë, përmbyllen në përputhje me ligjin procedurat e konfirmimit të nëpunësit civil, të cilat janë vendosur për të garantuar nga njëra anë parimet e shërbimit civil, e nga ana tjetër respektimin e të drejtave të nëpunësve civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, ligjin nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” si dhe në nenet 16 e 34, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015,

V E N D O S A:

1. Të kërkoj nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, të përmbyllë procesin e konfirmimit si nëpunës civil të nëpunësit *****, në përputhje me kërkesat e nenit 24, pika 3, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe pikës 6, e në vijim, të Kreut VI, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive” duke vepruar në këtë mënyrë:
 - ✓ Eprori direkt i pozicionit “Specialist Jurist, në Sektorin Juridik dhe Marrëdhënieve Ndërkombëtare”, të finalizojë periudhën e provës, me nxjerrjen e aktit individual përkatës të konfirmimit si nëpunës civil për punonjësin *****, duke marrë për bazë vlerësimin e punës të kryer nga Drejtori i DSIK, sipas përcaktimeve të pikave 6, 7 dhe 10, të Kreut VI, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”.
 - ✓ Vendimi i eprorit direkt, duhet t’i njoftohet nëpunësit ***** dhe njësisë përgjegjëse, Departamentit të Administratës Publike.
 - ✓ Departamenti i Administratës Publike, në kuptim të pikës 13, të kreut VI, të VKM nr. 243, datë 18.3.2015, në rastin e vendimit të konfirmimit, duhet të finalizojë këtë proces nëpërmjet nxjerrjes së aktit të deklarimit të statusit të nëpunësit ***** brenda 10 ditëve, nga data e njoftimit të konfirmimit nga institucioni, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe të realizojë shënimin përkatës në Regjistrin Qendror të Personelit.

2. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtori i Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, eprori direkt i nëpunësit *****_ Departamenti i Administratës Publike, njësia e burimeve njerëzore e institucionit, si dhe nëpunësi *****.
3. Për kryerjen e detyrave të përcaktuara më sipër, institucionit i lihet afat, **15** ditë.
4. Me kalimin e këtij afati, duhet të njoftohet me shkrim Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mënyrën e zbatimit të vendimit.
5. Në rast të moszbatimit të këtij vendimi paralajmërues, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për mos zbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA